



Ministria Federale
për Familjen të Moshuarit,
Gratë dhe Rininë



Fondacioni federal
Nëna dhe Fëmija





Informacione për gra shtatzëna që ndodhen në situatë të vështirë

Kur ofron ndihmë Fondacioni federal?

Ndodheni në një situatë të vështirë dhe prisni të lindni? Atëherë mund të aplikoni për të marrë ndihma nga Fondacioni federal në një nga këshillimoret e shtatzanisë, kur

- a) e keni vendbanimin ose banoni zakonisht në **Gjermani**,
- b) keni një **dokument për shtatzaninë** tuaj p.sh. një **fletore të ndjekjes së shtatzanisë** dhe
- c) ndodheni në një **situatë të vështirë** personale dhe financiare.

Për dhënien e ndihmave financiare duhet të verifikohet niveli i të ardhurave tuaja. Subvencionet e Fondacionit federal janë të mundura vetëm atëherë, kur përfitimet e tjera nga sigurimet shoqërore, duke përfshirë edhe ndihmën sociale, nuk mjaftojnë, nuk arrijnë në kohën e duhur te ju ose kur nuk keni të drejtë t'i merrni ato. **Kërkesa** për mbështetje financiare duhet paraqitur në një **qendër këshillimore për shtatzaninë** në kuadër të një këshillimi personal (**jo në Zyrën Qendrore të Fondacionit federal në Berlin**). Këshillimoret për shtatzaninë – edhe në afërsi të vendbanimit tuaj – i gjeni në librin e telefonit dhe në internet (p.sh. në adresën <https://www.bundesstiftung-mutter-und-kind.de/antragstellung>). Përpiquni që herët të siguroni një takim për t'u këshilluar, sepse kërkesa për mjetet financiare **duhet bërë gjatë shtatzanisë. Për çdo shtatzani mund të paraqitet vetëm një kërkesë.**

Si ndihmon Fondacioni federal?

Mjetet e Fondacionit ofrohen p.sh. për pajisjen fillestare të fëmijës, për vazhdimin e mirëmbajtjes së ekonomisë shtëpiake, për banesën dhe mobilimin si dhe për përkujdesjen për fëmijën e vogël. Subvencionet **nuk llogariten si të ardhura** mbi pagesën për të papunët II, ndihmën sociale dhe përfitime të tjera nga sigurimet shoqërore.

Shuma dhe kohëzgjatja e ndihmës orientohen në rrethanat tuaja personale, por edhe në numrin e përgjithshëm të paraqiteseve të kërkesave, të cilat ndodhen në gjendje të vështirë. Marrja e mbështetjes financiare nga Fondacioni federal **nuk është një e drejtë për të cilën mund të paraqitet pretendim juridik.**

Federata i vë në dispozicion Fondacionit federal për masat e tij financiare çdo vit të paktën 92 milionë euro. Ndihma e Fondacionit federal për **gratë shtatzëna në situatë të vështirë** kryhet përmes fondacioneve për gratë dhe familjen në vështirësi dhe përmes institucioneve të tjera të ngjashme qendrore në landet përkatëse federale. Ato organizojnë dhënien e ndihmave në vend.

Prej Fondacionit federal „Nëna dhe fëmija – mbrojtja e jetës së palindur“ çdo vit **mbështeten në formë joburokratike 150.000 gra shtatzëna që ndodhen në një situatë të vështirë**, për të lehtësuar vazhdimin e shtatzanisë dhe përkujdesjen për fëmijën e vogël.

Punën e Fondacionit Nëna dhe fëmija mund ta mbështesni me një donacion: IBAN: DE44 3708 0040 0270 2009 00, BIC: DRESDEFF370. Nga donacionet përfitojnë drejtpërdrejt gratë shtatzëna në situatë të vështirë. Donacionet mund të zbriten nga taksat.

BAZË PËR PUNËN E FONDACIONIT FEDERAL, QË EKZISTON QË PREJ VITIT 1984 ËSHTË LIGJI PËR NGRITJEN E NJË FONDACIONI „NËNA DHE FËMIJA – MBROJTJA E JETËS SË PALINDUR“.

Këtë dhe informacione të tjera i gjeni në adresën:

www.bundesstiftung-mutter-und-kind.de



Kjo fletëpalosje është pjesë e marrëdhënieve me publikun të Qeverisë Federale gjermane; ajo shpërndahet falas dhe nuk shitet.

Botuesi:

Bundesministerium
für Familie, Senioren, Frauen
und Jugend
Referat Öffentlichkeitsarbeit
11018 Berlin
www.bmfsfj.de

Për çështje të tjera përdorni:
Telefoni i shërbimit: 030 20179130
E hënë–E enjte ora 9–18
Faks: 030 18555-4400
E-Mail: info@bmfsfj.service.bund.de

Numri i përbashkët për informacione i administratës: 115*

Përditësuar më: Nëntor 2017 (Albanisch)

Koncepti: www.avitamin.de

Fotografia: Andy Kuechenmeister

* Për pyetje të përgjithshme për të gjitha zyrat dhe institucionet është në dispozicionin tuaj edhe numri i përbashkët për informacione i administratës 115. Në rajonet ku është aktivizuar 115 mund t'i telefononi këtij numri nga e hëna deri të premten, nga ora 8:00 deri 18:00. Numrit 115 mund t'i telefononi si nga rrjeti i telefonave fiks, ashtu edhe nga rrjetet e telefonave celularë me tarifën lokale telefonike dhe në këtë mënyrë falas në tarifën e fiksuar. Personat që nuk dëgjojnë mund të marrin informacione në adresën SIP 115@gebaerdentelefon.d115.de. Nëse është aktivizuar apo jo për rajonin tuaj numri 115 si dhe informacione të tjera për numrin e përbashkët për informacione të administratës, këtë e mësoni në <http://www.d115.de>